



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:026241

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874022

KPPP.nr.150/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.T.SH. “Fidanishtja Bytyqi”, me NUI:810316621, me seli në Klinë, fshati Drenoc, përfaqësuar sipas autorizimit nga Agon Rrecaj, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Gjini Construction” SH.P.K., me NUI:811274240, me seli në Suharekë, rruga “Brigada 123”, përfaqësuar sipas autorizimit nga Nadire Hoxha, avokate nga Suhareka, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.770/23 të datës 29.12.2023, të Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Gjini Construction” SH.P.K., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.770/23 të datës 29.12.2023, të Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.770/23 i datës 29.12.2023, i Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj.
- III. URDHËROHET debitori “Gjini Construction” SH.P.K., që në rast të parashtrimit ankesës, të deponoj në llogari të veçantë të “Këshillit Gjyqësor të Kosovës” nëpërmjet arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancionin në shumën prej 7,355.00 € (shtatë mijë e tre qind e pesëdhjetë e pesë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

IV. Nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.T.SH. “Fidanishtja Bytyqi”, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.770/23 të datës 29.12.2023, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.23/2021 të datës 11.07.2021, me të cilin ka detyruar debitorin që kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 7,355.00 €, me kamat ligjore 8% në vit, duke filluar nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, ashtu të bllokohen të gjitha llogaritë bankare pranë të gjitha bankave, po ashtu dhe me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit deri në arritjen e borxhit në tërësi si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se borxhi i kërkuar nga kreditori duhet të pranohet edhe njëherë nga ana e debitorit në mënyrë që i njëjti të hyj në pagesë reale. Tutje ka shtuar se punët nuk janë kryer, debitori ka kërkuar nga kreditori sanimin e punimeve ndërsa të njëjtat nuk janë bërë ashtu që debitori ka bërë sanimin e defekteve vet, ndërsa sa i përket faturës ka theksuar se edhe pse e njëjta është e nënshkruar nuk paraqet pasqyrim të saktë të borxhit si dhe e njëjta është fiktive. Gjykatës i ka propozuar që ta hedh poshtë propozimin për përmbartim.

Kreditori përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke theksuar se fatura është pranuar nga debitori, i njëjti e ka përmbushur pjesërisht detyrimin e tij në raport me kreditorin ashtu që me datë 29.10.2021 ka realizuar pagesën në shumë prej 10,000.00 €, po ashtu me datë 15.09.2023 ka realizuar pagesën në shumë prej 10,000.00 €, ndërsa ka mbetur pa paguar shumën prej 7,355.00 €. Tutje ka shtuar se fatura i plotëson të gjitha kushtet sipas LPP-së dhe se prapësimi i debitorit është ushtruar vetëm e vetëm për t’iu shmangur pagesës së detyrimit i cili rrjedh nga fatura e cila është objekt i kësaj procedure përmbartimore. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të

provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkak të si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Faturën Nr.23/2021 të datës 11.07.2021, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në kopje të vërtetuar, është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, gjë e cila vërtetohet nga nënshkrimi si dhe vula e debitorit.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk

lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin, në rast se parashtrohet ankesë kundër këtij aktvendimi, në afatin prej 7 ditëve, në momentin e parashtrimit të ankesës të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar nga gjykata si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.150/24, datë 28.06.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate